

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

12 Mars, 2021

Familje të nderuara,


Javën tjetër, Drejtoria Arsimore do të rihapë Proçesin e Zgjedhjes së Modelit të të Mësuarit, duke lejuar familjet PreK-2 që fillimisht zgjedhën modelin dixhital 100% në vjeshtë, mundësinë për të zgjedhur mësimin hibrid (një përzierje në -person dhe mësim dixhital çdo javë) këtë vit shkollor.

Dritarja e zgjedhjes do të hapet të Martën, 16 Mars dhe do të mbyllet të Martën, 23 Mars. I ngjashëm me proçesin e zgjedhjes vjeshtën e kaluar, familjet PreK-2 do të jenë në gjendje të zgjedhin midis modelit të të mësuarit hibrid dhe modelit 100% të mësimit dixhital - çfarëdo që funksionon më mirë duke pasur parasysh nevojat e fëmijës dhe familjes tuaj. Nëse zgjidhni të mësuarit hibrid, fëmija juaj do të ndjekë shkollën në - person dy ditë në javë dhe do të merret me mësim dixhital tre ditë çdo javë, bazuar në një orar të caktuar, duke filluar nga java e së Hënës, 5 Prill 2021. Këto orare janë të krijuara në mënyrë të ketë nje numër të caktuar nxënësish në shkolla çdo ditë dhe ndihmojnë në ruajtjen e distancës sociale në të gjitha hapësirat shkollore gjatë gjithë ditës.

Unë ju inkurajoj të shihni në video [Safe Return to School](#) dhe [Clean and Healthy Schools](#) dhe të vizitoni philasd.org/aes për të mësuar më shumë rreth masave të sigurisë për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e të gjithëve në shkollat tona. . Nëse keni akoma pyetje, mund të telefononi në linjën tonë për familjet anglishtfolëse në 215-400-5300, nga e Hëna deri të Premten nga ora 8 e mëngjesit deri në 4:30 pasdite. Linjat e telefonit në gjuhë të tjera mund të gjenden [këtu](#).

Ju do të merrni një lidhje/link për Pyetëtorin e Zgjedhjes së Modelit të Mësimit të Martën e ardhshme nga shkolla. Mos harroni të përgjigjeni para se anketimi të mbyllet në 23 Mars. Nëse nuk i përgjigjeni pyetësorit , fëmija juaj do të mbetet me 100% të mësuarit dixhital. Familjet që zgjedhin të mësuarit hibrid do të kontaktohen nga shkolla e fëmijës së tyre midis 24-26 Mars, 2021 në lidhje me hapat e ardhshëm. Si gjithmonë, familjet që zgjedhin të mësuarit hibrid mund të kthehen në mësimin dixhital 100% në çdo kohë.

Faleminderit për partneritetin tuaj të vazhdueshëm ndërsa ne vazhdojmë të mbështesim nevojat e të mësuarit të nxënësve tanë më të rinj.
Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias